



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 137

Tiranë – E mërkurë, 8 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13209, datë 7.9.2021	Për emërimin e rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike..... 13679
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave nr. 2, datë 20.8.2021	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”..... 13679
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 5.8.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë “Power-Elektrik- Slabinje” sh.p.k..... 13680
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 167, datë 5.8.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k..... 13682
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 170, datë 16.8.2021	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”..... 13684
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 16.8.2021	Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a..... 13686
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 16.8.2021	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror” (shitje me pakicë)..... 13688
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 16.8.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a..... 13690
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 317, datë 20.8.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mat sh.a..... 13692

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 318, datë 20.8.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Skrapar sh.a.....	13693
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 319, datë 20.8.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Has sh.a.....	13694
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 320, datë 20.8.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Delvinë sh.a.....	13695



DEKRET

NR. 13209, datë 7.9.2021

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
AKADEMISË SË STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g” dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë siaps nenit 7, pika 2, germa “j”, të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 4141/3, prot., datë 30.8.2021,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Luan Përzhitë emërohet rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 2, datë 20.8.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, KDZH, i ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, u mblodh me datë 20.8.2021, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

- Fondi 284/AP “Organizata e Partisë në Francë”

Viti 1952, dosjet nr. 5, 6, 9. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1953, dosjet nr. 1, 2, 4, 10, 12. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1954, dosjet nr. 4, 14. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1955, dosjet nr. 6, 7, 9, 11, 12. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1956, dosjet nr. 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1957, dosjet nr. 10, 11, 12, 15. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1958, dosjet nr. 16, 17, 18. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1959, dosjet nr. 2, 3, 6, 10, 11. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1960, dosjet nr. 3, 5, 6, 7. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1961, dosjet nr. 1, 2, 3, 4, 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1962, dosja nr. Niveli i klasifikimit “T. sekret”.

Viti 1964, dosjet nr. 3, “T. sekret”, 4, 5, 6. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1965, dosjet nr. 1, 2, 3, 4, 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1966, dosjet nr. 1, 2. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1967, dosjet nr. 3, 4, 6, 7, 9, 10, 11. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1968, dosjet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1969, dosjet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1970, dosjet nr. 1, 8. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1973, dosja nr. 4. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1974, dosjet nr. 1, 2, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1975, dosjet nr. 1, 3, 6, 7. Niveli i klasifikimit “Sekret”.



Viti 1981, dosja nr. 8. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1982, dosja nr. 8. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1983, dosja nr. 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1984, dosja nr. 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1985, dosjet nr. 3, 4, 6. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1986, dosjet nr. 3, 8, 9. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika “b” e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017.

2. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

3. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Dr. Ardit Bido

VENDIM Nr. 166, datë 5.8.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR DEROGIM TË SHOQËRISË “POWER- ELEKTRIK-SLABINJE” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 54, paragrafi 1 dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 186, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; neneve 16, 60 dhe 61, pika 1, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të

datës 5.8.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 110/1 prot., datë 29.7.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë ‘Power-Elektrik-Slabinje’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, ka miratuar “Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”. Në këtë akt rregullator parashikohet se në kuptim të nenit 60, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, autoriteti rregullator mundet t’i japë pronarëve të objektit gjenerues ose pronarëve të ardhshëm, ose operatorit të rrjetit, derogime, sipas një ose më shumë dispozitave të Kodit për Modulet Gjenerues të Rinj dhe Ekzistues.

- Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 29/6 prot., datë 30.6.2021, protokolluar në ERE me nr. 789 prot., datë 30.6.2021, ka paraqitur kërkesën për derogim lidhur me përcaktimet e nenit 54, paragrafi 1, dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018.

- Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., me numër identifikues NIPT K81813003S, është mbajtëse e licencës nr. 93, seria PV10K, “Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 95, datë 16.7.2012.

- Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. është zotëuese e HEC “Slabinje”, me fuqi të instaluar 13.08 mw. Hidrocentrali nëpërmjet një nënstacioni ngritës TM/110 kV lidhet me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike.

- HEC “Slabinje” klasifikohet si njësi gjeneruese e tipit D, pasi lidhet në rrjetin 110 kV. Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, u mundësojnë këtyre njësisve gjeneruese të kërkojnë derogim.

- Shoqëria e ka realizuar hidrocentralin me teknologji kineze dhe, për rrjedhojë, me gjithë



përpjekjet e vazhdueshme për të bërë integrimin e HEC-it në sistemin SCADA të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), nuk ka mundur ta realizojë këtë integrim, kjo për faktin se sistemi SCADA i OST sh.a., është prodhim ABB dhe nuk realizohet ndërfaqja me sistemet kineze.

- Në këto rrethana shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. kërkon derogim për sa përcaktohet në nenin 54, paragrafi 1, dhe nenin 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit.

- Afati i derogimit të kërkuar nga ana e shoqërisë është 24 muaj, në mënyrë që të krijohet mundësia për gjetjen e një zgjidhjeje teknike për integrimin e HEC-it të shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., në sistemin SCADA të OST sh.a.

- Aplikimi për derogim i shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje sh.p.k., është bërë bazuar në kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, të Bordit të ERE-s, dhe periudha 24-mujore e kërkuar është konform përcaktimeve të nenit 12, pika 4, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186/2017, ndryshuar me vendimin nr. 129/2018.

- ERE, bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 1, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve, nëpërmjet shkresës nr. 789/1 prot., datë 8.7.2021, ka kërkuar opinionin e operatorit të rrjetit ku janë lidhur njësitë gjeneruese, OST sh.a., në lidhje me derogimin e kërkuar nga shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k.

- OST sh.a., në përgjigje të kërkesës së bërë nga ERE, me shkresën e sipërcituar, nëpërmjet shkresës nr. 4407/1 prot., datë 16.7.2021, ka parashtruar se shoqëri të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike kanë zhvilluar dhe realizuar projektet e tyre në kohë të ndryshme. Në këto kushte, edhe zhvillimi i sistemit SCADA të OST sh.a. ka qenë në zhvillim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë, shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike, përfshi dhe shoqërinë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. kanë implementuar teknologji dhe SCADA lokale, e cila paraqet vështirësi për integrimin dhe ndërfaqen me sistemin SCADA të OST sh.a. Po ashtu, në këtë komunikim OST sh.a. është shprehur, se: “derogimi i paraqitur për

opinion në OST sh.a. nuk cenon operimin dhe funksionimin normal të sistemit të transmetimit. Ky derogim është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare, gjatë së cilës shoqëria duhet të marrë masa për plotësimin e kërkesave të nenit 54(1) dhe 55(1) të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin”.

- Për sa më sipër, OST sh.a. ka evidentuar faktin se derogimi i kërkuar nga shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., nuk cenon funksionimin normal të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Derogimet të merren në konsideratë dhe në marrëveshjet e nënshkruara me OST sh.a. dhe të mos pengojnë operimin normal të HEC-it të shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., në rrjet për periudhën e kërkuar të derogimit.

- OST sh.a. dhe shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike për të garantuar sigurinë e operimit të veprës dhe të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për derogim e shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. është publikuar në faqen e internetit të ERE-s në zërin “Konsultime”, më datë 5.7.2021, në mënyrë që të sigurohet transparenca e duhur për këtë proces dhe t’u jepet mundësia palëve të treta për ndonjë opinion apo koment të mundshëm, dhe deri më datë 5.8.2021 nuk është paraqitur asnjë opinion apo koment nga këto të fundit.

- Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., si më poshtë vijon:

a) Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit 54, paragrafi 1 dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 186, datë 10.11.2017, të ndryshuar, për njësitë gjeneruese të shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k.

b) Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., të vijojë të operojë e lidhur me sistemin e



transmetimit, duke marrë në konsideratë sa përcaktuar në këtë derogim.

c) Afati i derogimit është për një periudhë 24 muaj.

2. Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. të informojë ERE-n dhe OST sh.a, çdo 6 muaj mbi ecurinë e implementimit të teknologjisë SCADA lokale për integrimin dhe ndërfaqen me sistemin SCADA të OST sh.a.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë aplikuesin dhe shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 167, datë 5.8.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR
DEROGIM TË SHOQËRISË
“HIDROPOWER ELEKTRIK” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 54, paragrafi 1 dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 186, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; neneve 16, 60 dhe 61, pika 1, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; kritereve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në

mbledhjen e tij të datës 5.8.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 110/2 prot., datë 29.7.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë ‘Hidropower Elektrik’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, ka miratuar “Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”. Në këtë akt rregullator parashikohet se në kuptim të nenit 60, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, autoriteti rregullator mundet t’i japë pronarëve të objektit gjenerues ose pronarëve të ardhshëm ose operatorit të rrjetit, derogime sipas një ose më shumë dispozitave të kodit për modulet gjenerues të rinj dhe ekzistues.

- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 6/28 prot., datë 29.6.2021, protokolluar në ERE me nr. 790 prot., datë 30.6.2021, ka paraqitur kërkesën për derogim lidhur me përcaktimet e nenit 54, paragrafi 1, dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 186, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018.

- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 130, seria PV11K, “Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e Bordit nr. 194, datë 30.8.2018, si dhe mbajtëse e licencës nr. 267, seria T15P, “Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015, për një afat 26-vjeçar.

- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. është zotëruese e HEC “Sllabinja 2B”, me fuqi të instaluar 1800 kw; HEC “Sllabinja 2C”, me fuqi të instaluar 3400 kw; HEC “Sllabinja 2D&2D/1”, me fuqi të instaluar N/1. = 4885 kw dhe N/2 = 1200 kw; HEC “Sllabinja 2E”, me fuqi të instaluar 3800 kW. Fuqia totale e instaluar N = 15085 kw.

- HEC-et e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. lidhen me rrjetin e transmetimit nëpërmjet N/ST 110/6.3 kV të HEC “Sllabinja



2E”, me fuqi të instaluar 10 mVA, dhe nëpërmjet N/ST 110/20/6.3 HEC “Sllabinja 2D”, me fuqi të instaluar 14.5 mVA.

- HEC-et e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. klasifikohen si njësi gjeneruese e tipit D, pasi lidhen në rrjetin 110 kV. Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, u mundësojnë këtyre njësite gjeneruese të kërkojnë derogim.

- HEC-et e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., janë realizuar me teknologji kineze, gjithashtu, të gjitha pajisjet e instaluar janë pajisje kineze dhe, për rrjedhojë, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të realizuar integrimin e HEC-ve në sistemin SCADA të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), shoqëria nuk ka mundur ta realizojë këtë integrim, kjo për faktin se sistemi SCADA i OST sh.a., është prodhim ABB dhe nuk realizohet ndërfaqja me sistemet kineze.

- Në këto rrethana, shoqëria kërkon derogim për sa përcaktohet në nenin 54, paragrafi 1, dhe nenin 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit.

- Afati i derogimit të kërkuar është 24 muaj, në mënyrë që të krijohet mundësia për gjetjen e një zgjidhjeje teknike për integrimin e HEC-ve të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., në sistemin SCADA të OST sh.a.

- Aplikimi për derogim i shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. është bërë bazuar në kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, të Bordit të ERE-s, dhe periudha 24-mujore e kërkuar është konform përcaktimeve të nenit 12, pika 4, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186/2017, ndryshuar me vendimin nr. 129/2018.

- ERE, bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 1, të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, nëpërmjet shkresës nr. 790/1 prot., datë 8.7.2021, ka kërkuar opinionin e operatorit të rrjetit ku janë lidhur njësite gjeneruese, OST sh.a., në lidhje me derogimin e kërkuar nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k.

- OST sh.a., në përgjigje të kërkesës së bërë nga ERE me shkresën e sipërcituar, nëpërmjet shkresës nr. 4405/1 prot., datë 16.7.2021, ka parashtruar si vijon:

- Shoqëri të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike kanë zhvilluar dhe realizuar projektet e tyre në kohë të ndryshme. Në këto kushte edhe zhvillimi i sistemit SCADA të OST sh.a. ka qenë në zhvillim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë, shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike, përfshi dhe shoqërinë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., kanë implementuar teknologji dhe SCADA lokale, e cila paraqet vështirësi për integrimin dhe ndërfaqen me sistemin SCADA të OST sh.a.

- OST sh.a. është shprehur, se: “nuk cenon operimin dhe funksionimin normal të sistemit të transmetimit. Ky derogim është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare, gjatë së cilës shoqëria duhet të marrë masa për plotësimin e kërkesave të nenit 54(1) dhe 55(1), të Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin.

- Për sa më sipër, OST sh.a. ka evidentuar faktin se derogimi i kërkuar nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. nuk cenon funksionimin normal të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Derogimet e kërkuara të merren në konsideratë dhe në marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. dhe OST sh.a., dhe të mos pengojnë operimin normal të HEC-ve të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. në rrjet, për periudhën e kërkuar të derogimit.

- OST sh.a. dhe shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., duhet të marrin masat e nevojshme teknike për të garantuar sigurinë e operimit të veprës dhe të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për derogim e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. është publikuar në faqen e internetit të ERE-s, në zërin “Konsultime”, më datë 5.7.2021, në mënyrë që të sigurohet transparenca e duhur për këtë proces dhe t’u jepet mundësia palëve të treta për ndonjë opinion apo koment të mundshëm, dhe deri më datë 5.8.2021, nuk është paraqitur asnjë opinion apo koment nga këto të fundit.



- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., si më poshtë vijon:

a) Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit 54, paragrafi 1, dhe nenit 55, paragrafi 1, të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 186, datë 10.11.2017, për njësitë gjeneruese të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k.

b) Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. të vijoje të operojë e lidhur me sistemin e transmetimit, duke marrë në konsideratë sa përcaktuar në këtë derogim.

c) Afati i derogimit është për një periudhë 24 muaj.

2. Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. të informojë ERE-n dhe OST sh.a. çdo 6 muaj mbi ecurinë e implementimit të teknologjisë SCADA lokale, për integrimin dhe ndërfaqen me sistemin SCADA të OST sh.a.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë aplikuesin dhe shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 170, datë 16.8.2021

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN DHE METODOLOGJINË PËR LLOGARITJEN DHE VENDOSJEN E DËMIT EKONOMIK TË SHKAKTUAR NGA NDËRRHYRJET E PALIGJSHME NË SISTEMIN E MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në zbatim të nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 15, 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 16.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 112/4 prot., datë 12.8.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 232, datë 20.12.2019, ka miratuar “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 25.2.2021, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në nenin 10, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, për afatet e lëshimit të faturës për përdoruesin e rrjetit dhe njoftimin e furnizuesit.

- Me shkresën nr. 443 prot., datë 12.3.2021, ERE ka njoftuar palët e interesuara në proces, si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), OSSH sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Autoriteti i Konkurrencës, mbi vendimin e Bordit nr. 61,



datë 25.2.2021 dhe ka kërkuar të marrë mendim lidhur me fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik, të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 519/1 prot., datë 12.7.2021, ERE ka ftuar Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Konsumatorin në Fokus, Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, Qendrën “Konsumatori Shqiptar” dhe Avokatin e Popullit për shprehje mendimi lidhur me propozimin e shoqërisë OSSH sh.a.

- Në përfundim të afateve për marrje mendimi nga palët e tjera të interesuara, MIE, me shkresën nr. 2630/1 prot, datë 21.6.2021, është shprehur, se: “lidhur me ndryshimet në nenin 2 (objekti i Rregullores), shprehemi se objekti i Rregullores dhe metodologjisë është i mirëpërkufizuar dhe gjithëpërfshirës, dhe se shtesat e propozuara janë elemente të karakterit teknik dhe nuk ka pse të përfshihen në objektin e Rregullores. Për më tepër, nuk është parashtruar se si do të procedohej për rastet e propozuara lidhur me vlerësimin e dëmit, që në çdo rast do të duhej të reflektohej në seksione të tjera të Rregullores. Për sa u takon ndryshimeve në nenin 10, lidhur me afatin e lëshimit të faturës dhe njoftimin e furnizuesit, shprehemi në parim dakord”.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 147/3 prot., datë 2.8.2021, protokolluar në ERE me nr. 443/2 prot., datë 4.8.2021, shprehet se procedura e ndjekur dhe vendimi nr. 61/2021, të Bordit të ERE-s, nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

- Shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 5997/1 prot., datë 12.7.2021, ka paraqitur edhe propozimin e plotë për ndryshimet në nenin 10, të Rregullores, si me poshtë vijon:

Neni 10, pika 1:

Ishte:

OSSH-ja sigurohet që të informojë furnizuesin dhe përdoruesin e rrjetit, në çdo rast që konstaton dëm ekonomik të shkaktuar nga një përdorues i rrjetit, me të cilin furnizuesi ka një kontratë furnizimi, jo më vonë se 48 orë nga

konstatimi, përpara ndërmarrjes së ndonjë veprimi kundrejt përdoruesit të rrjetit.

Bëhet:

OSSH-ja sigurohet që të informojë furnizuesin dhe përdoruesin e rrjetit në çdo rast, që konstaton dëm ekonomik të shkaktuar nga një përdorues i rrjetit, me të cilin furnizuesi ka një kontratë furnizimi, në momentin e emetimit të faturës së dëmit ekonomik.

Neni 10, pika 2:

Ishte:

OSSH-ja lëshon faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përlogaritur për përdoruesin e rrjetit, jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi, e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj.

Bëhet:

OSSH-ja lëshon një faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përlogaritur për përdoruesin e rrjetit, brenda ciklit të leximit/faturimit (30 ditë), e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj.

- Këto ndryshime të propozuara nga OSSH sh.a. mbështeten në arsyetimin, se në kushtet kur OSSH sh.a. punon me cikël 30-ditor të sistemit të lexim/faturimit, do të ishte më e përshtatshme që afati i lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda ciklit mujor të lexim/faturimit. Gjithashtu, propozimi për njoftimin e furnizuesit dhe të përdoruesit të rrjetit, në momentin e lëshimit të faturës përkatëse, OSSH sh.a. e shënjon si moment të zyrtarizmit të shkeljes/ndërhyrjes së paligjshme në sistemin e tij.

- Për sa konstatohet, arsyetimet dhe ndryshimet e propozuara në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, gjykohen të pranueshme.

- Gjithashtu, theksohet se këto ndryshime në Rregullore, nuk cenojnë të drejtat e konsumatorëve të parashikuara në nenin 11, të së njëjtës Rregullore, si e drejta e ankimit në OSSH dhe/ose në ERE, në rast se kundërshton faturën e dëmit ekonomik të vendosur nga OSSH ose



pretendon se OSSH nuk ka ndjekur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Rregulloreje. Po ashtu nuk cenohen afatet e ankimit qoftë drejtpërdrejt tek operatori, qoftë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në nenin 10, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

2. Neni 10, pika 1, e Rregullores:

Bëhet:

OSSH-ja sigurohet që të informojë furnizuesin dhe përdoruesin e rrjetit në çdo rast që konstaton dëm ekonomik të shkaktuar nga një përdorues i rrjetit, me të cilin furnizuesi ka një kontratë furnizimi, në momentin e emetimit të faturës së dëmit ekonomik.

Neni 10, pika 2:

Bëhet:

OSSH-ja lëshon faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përlogaritur për përdoruesin e rrjetit, brenda ciklit të leximit/faturimit nga momenti i konstatimit, e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 171, datë 16.8.2021

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, “ALBGAZ” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; pikës 76, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 112/3 prot., datë 12.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 28.12.2020, ka vendosur:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a.

- Në vijim, me vendimin nr. 63, datë 1.3.2021, Bordi ka vendosur:

1. Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a.

- Bazuar në kërkesën e vetë shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të vendimmarrjes, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 30.3.2021, vendosi:

1. Të zgjasë deri më 30.6.2021, afatin e dorëzimit të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/6 prot., datë 11.6.2021, shoqëria ka depozituar



në ERE programin e përputhshmërisë në anglisht e po ashtu ka dhënë disa argumente në lidhje me konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 28.12.2020, me anë të të cilit filloi dhe procedura për miratimin e këtij programi.

- Në lidhje me konstatimin se kudo në tekst akronimi OST duhet të zëvendësohet me “Albgaz” sh.a., shoqëria shprehet se që në titull është vendosur emri i shoqërisë “Albgaz” sh.a., e po ashtu është vendosur shpjegimi në tekst se këtu e më poshtë do të jetë OST-ja. Sa argumentuar nga shoqëria vlerësohet se duhet marrë në konsideratë.

- Në lidhje me konstatimet që i referohen pikës 5 dhe 6, të kreut II, të Programit të Përputhshmërisë (statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST-së) dhe të pikës 15, të kreut III, që ka të bëjë me ndarjen e pronësisë dhe pavarësinë e OST-së, shoqëria ka argumentuar se “Albgaz” sh.a. është themeluar nëpërmjet VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, e ndryshuar, dhe ka vetëm një aksioner të vetëm, shtetin, ku autoriteti publik me 100% (një qind për qind) të aksioneve të shoqërisë është MIE. Për sa referuar, shoqëria sqaron se këto janë trajtuar dhe gjatë procesit të certifikimit të “Albgaz” sh.a. dhe për të ka pasur një korrespondencë shteruese ndërmjet ERE-s, MIE-s dhe “Albgaz” sh.a.

- Për sa argumentuar më sipër nga shoqëria, vlerësohet të theksohet se në vendimin e fillimit të procedurës, këto konstatime janë nxjerrë në referim të specifikimeve e programit tip, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017, si vijon:

- Në pikën 5, të Programit të Përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017, përcaktohet se duhet të shpjegohet struktura e aksioneve të kompanisë OST, duke përfshirë marrëdhënien e aksionerëve të OST-së me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike ose ato që kanë ndonjë interes komercial. Sa konstatuar nga programi i përputhshmërisë i dërguar nga “Albgaz” sh.a. është përcaktuar se aksioneri i vetëm është MIE, por nuk është përfshirë në këtë program ndonjë marrëdhënie e këtij aksioneri siç përcaktuar më sipër.

- Në pikën 6, të Programit të Përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 77/2017, përcaktohet se duhet të shpjegohet ndarja dhe pavarësia e organeve publike, të cilat janë të autorizuar të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore, nga njëra anë, dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin, nga ana tjetër. Sa më sipër vlerësohet që të parashikohet dhe në Programin e Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

- Në pikën 15, të Programit të Përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017, parashikohet se duhet të përcaktohen qartë drejtuesit e OST-së, sipas funksioneve që mbajnë në organet apo strukturën e “Albgaz” sh.a., për të cilët është e detyruar që të ndiqen kriteret e përcaktuara në pikat 15.1–15.6.

- Për sa më sipër dhe pavarësisht argumentimit të “Albgaz” sh.a. se këto përcaktime janë trajtuar gjatë procedurës së certifikimit, vlerësohet se këto përcaktime duhet të përfshihen në Programin e Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., për arsye se vetë certifikimi kërkon hartimin e një programi përputhshmërie dhe këto janë kërkesa të programit tip të miratuar nga ERE që duhet të reflektohen te programi i OST-së. Sa më sipër, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë, që të përditësojë Programin e saj të Përputhshmërisë, me përcaktimet sipas pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të programit tip, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017 dhe ta depozitojë këtë program të përditësuar në ERE brenda 3 muajve.

- Në lidhje me konstatimin për përfshirjen e Asamblesë së Përgjithshme të “Albgaz” sh.a. si organ drejtues i shoqërisë që miraton Programin e Përputhshmërisë, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, shoqëria ka sqaruar se miratimi i programit nga Asambleja e Përgjithshme nuk kërkohej në mënyrë eksplicite, as nga statuti i “Albgaz” sh.a., e as nga dispozitat e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe as nga programi standard i miratuar nga ERE. Nisur nga fakti që në aktet ligjore e nënligjore nuk përcaktohen në mënyrë specifike organet drejtuese që duhet të miratojnë Programin e Përputhshmërisë, pasi kjo varet dhe nga organizimi i shoqërisë, vlerësohet që të pranohet argumenti i shoqërisë. Organi drejtues i shoqërisë që miraton Programin e Përputhshmërisë apo dhe ndryshimet e



mundshme të tij në vijim, të jetë Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

- Në përfundim të afatit ka rezultuar se palët e interesit, të cilave u është dërguar programi për marrje mendimi (MIE, AK-ja dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë) nuk kanë depozituar komente.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a., me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

2. Mosplotësimi i kushtit, sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojnë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrir Ahmeti**

VENDIM

Nr. 172, datë 16.8.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 90, DATË 6.4.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBPETROL’ SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR” (SHITJE ME PAKICË)

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c” dhe nenit 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 9, pika 1, germa “d”/vi; si dhe nenit 9, pika 1, germa “e”/i, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 97, datë 4.7.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/4-1 prot., datë 11.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror” (shitje me pakicë)”,

konstatoi se:

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 6.4.2021, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar, me kusht që brenda 3 (tre) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE:

a) vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për administratorin e ri të saj dhe vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me data të përditësuar;

b) deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe



sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit.

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., të depozitojë në ERE përpara fillimit të operimit dokumentacionin pronësor dhe lejet mjedisore në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 120/6 prot., datë 9.4.2021, duke i njoftuar vendimin përkatës dhe ka bërë me dije detyrimin për të paraqitur brenda afateve të vendimit, dokumentacionin e munguar, pjesë e kushteve të tij.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. me shkresat e protokolluara në ERE, nr. 120/7 prot., datë 25.6.2021 dhe nr. 120/8 prot., datë 6.7.2021, ka përcjellë dokumentacion në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit, dhe nga analizimi i tij rezulton plotësimi i kushteve si më poshtë:

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “a”, vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për administratorin e ri të saj dhe vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me data të përditësuara, është plotësuar nga shoqëria;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “b”, deklaratime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit”, konsiderohet i plotësuar pjesërisht duke qenë se “Albpetrol” sh.a. ka detyrime (gjyba dhe kamatëvones) ndaj institucionit tatimor. Ndodhur në këto rrethana u vlerësua vendosja e një kushti për depozitim në vijim të vërtetimit respektiv pa detyrime tatimore, i cili nuk lidhet me fillimin e operimit të aktivitetit të licencuar, duke i dhënë mundësinë shoqërisë që të krijojë të ardhura nga veprimtaria e licencuar, për shlyerjen e debive ndaj tatimeve dhe t’i demonstrojë ato periodikisht në ERE (siç edhe vetë shoqëria ka deklaruar);

- kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 90, datë 6.4.2021, “Shoqëria ‘Albpetrol’ sh.a., të depozitojë në ERE përpara fillimit të operimit dokumentacionin pronësor dhe lejet mjedisore në origjinal ose të njësuar me origjinalin”, është plotësuar nga shoqëria. Megjithatë, në kuptim të parashikimeve të nenit 9, pika 1, germa “d”/vi, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e

licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, shoqëria “Albpetrol” sh.a., duhet të depozitojë në mënyrë periodike në ERE çdo dokument pronësor dhe mjedisor që i shërben ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.4.2021, bëhen ndryshimet si vijon:

a) Pika 1

Bëhet:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

b) Pika 2

Bëhet:

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. duhet të depozitojë çdo 3 (tre) muaj në ERE çdo dokument pronësor dhe mjedisor që i shërben ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

c) Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

3. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të dokumentojë në ERE brenda 6 (gjashtë) muajve kryerjen e të gjitha pagesave ndaj institucionit të tatimeve.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 173, datë 16.8.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SHA, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 1.3, të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.6.2016; neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 112/2 prot., datë 11.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Elva 2001”, me shkresën nr. 14 prot., datë 20.6.2021, depozituar në ERE më datë 22.6.2021, protokolluar me tonën nr. 767 prot., ka kërkuar miratimin për lënien peng të aseteve të paluajtshme, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të lëvrimit të dy kredive për ndërtimin e HEC-it “Mivas”, si dhe për mbulimin e pagesave të furnitorëve.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 2.7.2021, ka vendosur:

- *Shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës së shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., deri në 30 ditë pune.*

- Kjo vendimmarrje e Bordit erdhi për shkak se lindi nevoja për sqarime rreth dokumentacionit të këtij aplikimi, përkatësisht në lidhje me arsyet që kanë çuar në ristrukturimin e dy kredive, depozitimin e marrëveshjeve të mundshme të hipotekimit/barrësimit, si dhe listës së aseteve me vlerat respektive.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 767/2 prot., datë 8.7.2021, duke i kërkuar dokumentacion/sqarimet e nevojshme sa lënë detyrë edhe në mbledhjen respektive ku u trajtua kjo çështje.

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE nr. 767/3 prot., datë 19.7.2021, si dhe nr. 767/5 prot., datë 4.8.2021, ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion në kuadër të aplikimit të saj.

- Po ashtu, me shkresën nr. 767/5 prot., datë 4.8.2021, shoqëria ka kërkuar që për realizimin e hipotekës në favor të Bankës, të marrë miratimin e ERE-s për lënien peng të aseteve, pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe kuotat e shoqërisë. Lidhur me këtë kërkesë, vlen të sqarohet se ERE, në zbatim të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 21.7.2016, shprehet vetëm për lënien peng për asetet e paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar. Për sa i përket lënies peng të kuotave, duhet theksuar, gjithashtu, se në zbatim të pikës 6.2, të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, kjo trajtohet nga ERE në një procedurë më vete dhe, se në këtë aplikim shoqëria nuk ka sjellë asnjë dokument në lidhje me marrjen e miratimit të ERE-s për të lënë peng kuotat në favor të Bankës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “Elva 2001” sh.a., në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi ka mungesat si më poshtë:

- Neni 7, “Përbërja e kërkesës për transferim”

Pika 1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- Germa “a” (një ekstrakt historik i shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit). Plotësuar pjesërisht.



Shoqëria duhet të përcjellë ekstraktin historik më datë të përditësuar.

- Germa “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve). Pa plotësuar.

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Germa “d” (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare). Pa plotësuar.

Shoqëria nuk ka depozituar në ERE një informacion të tillë, ndaj duhet të përcjellë sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Germa “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit). Pa plotësuar.

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE informacionin përkatës mbi efektet e pritshme të këtij transferimi.

- Germa “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar). Pa plotësuar.

Shoqëria nuk e ka paraqitur një informacion të tillë ndaj në vijim do t'i kërkohej të përcjellë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Germa “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohej të transferohen). Plotësuar pjesërisht.

Shoqëria ka përcjellë në ERE dy kontrata kredie bankare, të lidhura me “Intesa Sanpaolo Albania” Bank sh.a., me objekt ndërtimin e HEC-i “Mivas”, përkatësisht më 17.7.2019 dhe 8.10.2019, së bashku me amendimet përkatëse që i janë bërë në vijim këtyre kontratave, si dhe kontratat e hipotekës, dorëzanisë dhe marrëveshjet e sigurimit, për të garantuar detyrimin përkatës sipas kontratave të kredive. Sa konstatuar, në kontratat e hipotekës është cituar se gjendet bashkëlidhur dhe aneksi 1, ku përfshihet lista e aseteve, por ky dokument nuk është depozituar në ERE. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE këtë dokumentacion, në mënyrë që ERE të vlerësojë kompetencën e saj

në zbatim të legjislacionit në fuqi në lidhje me transferimin e këtyre aseteve.

- Germa “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.

Shoqëria nuk ka depozituar një dokument të tillë në ERE, ndaj do t'i kërkohej të përcjellë sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Germa “j” (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Pika 3. (Subjektet koncensionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e autoritetit shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.) Plotësuar pjesërisht.

Shoqëria ka përcjellë në aplikimin e saj shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 2771/1 prot., datë 16.6.2021, drejtuar Bankës “Intesa Sanpaolo”, e cila ndër të tjera ka theksuar, se: “kuptohet që në bazë të kontratës, koncepti i transferimit të aksioneve/kapitalit themeltar të të tretët, nuk mund të lidhet me kërkesën tuaj si palë financuese dhe njohjen asaj të drejtën e zëvendësimit të koncesionarit, pasi kontrata e sipërcituar nuk është kontratë koncesionare dhe në asnjë rast në të nuk është përcaktuar se, shoqëria “Elva 2001” sh.a., të vendosë në favor të ndonjë banke, lënien peng/barrë siguroese të radhës së parë mbi asetet e krijuara apo që do të krijohen nga zbatimi i punimeve të këtij projekti”.

Neni 15, “Kufizimet”, i kontratës nr. 5 rep., nr. 3/3 kol, datë 25.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Mivas’, me kapacitet prodhues 1.940 MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Tomorricë, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, nuk kufizon të drejtën për transferimin e aseteve të të licencuarit, por



vendos kufizim vetëm për transferim të kapitalit dhe aksioneve të shoqërisë të tretët.

ERE i është drejtuar MIE-s, me shkresën nr. 767/3 prot., datë 8.7.2021, me një kërkesë për sqarim të qëndrimit të mbajtur prej saj në shkresën nr. 2771/1 prot., datë 16.6.2021, por deri tani nuk ka ende një kthim përgjigje. Në çdo rast, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/përkatëse nga organet e tjera, kur kjo kërkohet nga këto organe.

- Pika 6. (Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre.) Pa plotësuar.

Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse dëshiron që pjesë të dokumentacionit të aplikimit të mos jenë të hapura për publikim, ndaj në vijim do t'i kërkohet të shprehet nëse e kërkon një kufizim të tillë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 317, datë 20.8.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MAT SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat (UK Mat), me shkresën nr. prot. 177, datë 3.6.2021, plotësime me shkresën nr. prot. 275, datë 21.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Mat, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).



3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Mat ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 36 908 banorë të Bashkisë Mat;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Nazmi Mallunxa është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë, dega Metalurgji, në vitin 1981 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mat, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mat është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. (me NUIS J68103917F), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Artan Thomaraj;

b) drejtues teknik – Nazmi Mallunxa.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. është Bashkia Mat.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 318, datë 20.8.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME SKRAPAR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a.”,



VËREN SE:

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar (UK Skrapar), me shkresën nr. 121 prot., datë 1.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Skrapar, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Skrapar ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 005 banorë të Bashkisë Skrapar;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Fatjon Hysi është diplomuar në *Bachelor* në Universitetin “Ismail Qemali”, Fakulteti i Shkencave Teknike Vlorë, dega inxhinieri elektrike, në vitin 2015.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Skrapar, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Skrapar është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a. (me NUIS J69102437J), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor – Sokol Çeçaj;

b) drejtues teknik – Fatjon Hysi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a. është Bashkia Skrapar.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Skrapar sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndiriçim Shani

VENDIM

Nr. 319, datë 20.8.2021

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJIELLËS HAS SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),



KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Has sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjetllës Has (U Has), me shkresën nr. 20 prot., datë 9.6.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të U Has në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria U Has ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 8 810 banorë të Bashkisë Has;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Hajredin Cahani është diplomuar në vitin 1978, si teknik i mesëm ndërtimi.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Has, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetllësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e U Has, është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Has sh.a. (me NUIS J66702907H), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

2. Shoqëria Ujësjetllës Has sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor – Xhemil Thaçi;

b) drejtues teknik – Hajredin Cahani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Has sh.a. është Bashkia Has.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Has sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike- Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Has sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 320, datë 20.8.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJETLLËS-KANALIZIME DELVINË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me



ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë (UK Delvinë) me shkresën nr. prot. 137 prot., datë 19.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Delvinë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Delvinë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 783 banorë të Bashkisë Delvinë;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Vani Toti është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë, dega Hidroteknike, në vitin 1986;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Delvinë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e

interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Delvinë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. (me NUIS K46909504W), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Vasil Marga;

b) drejtues teknik – Vani Toti.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. është Bashkia Delvinë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë